VENDIM
Nr.792, datë 16.12.2005

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.711, DATË 27.12.2001 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR STRUKTURËN DHE NIVELET E PAGAVE TË NËPUNËSVE CIVILË NË INSTITUCIONET E ADMINISTRATËS QENDRORE, ADMINISTRATËS SË PRESIDENTIT DHE KUVENDIT DHE DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.726, DATË 21.12.2000 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR PAGAT E PUNONJËSVE TË INSTITUCIONEVE BUXHETORE, NDRYSHUAR ME VENDIMET PËRKATËSE", TË NDRYSHUAR"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 18 e 29 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil" dhe të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës", me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.711, datë 27.12.2001 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në pikën 7 të bëhet ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

a) Shkronja "b" ndryshohet, si më poshtë vijon:

"Sekretar i Kryeministrit, i Presidentit, i Kryetarit të Kuvendit, i zëvendëskryeministrit, nënkryetar i Kuvendit

50 666;

Sekretar i ministrit, sekretar, sekretar i këshilltarit të Presidentit

40 326."

b) Në fund të shkronjës "c" shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

"Shtesa për vjetërsi në punë e punonjësve të përcaktuar në shkronjën "b" të pikës 7, të jepet në masën 2 për qind, pas çdo viti pune, deri në 25 vjet dhe llogaritet mbi vlerën 9306 lekë".

2. Në lidhjen nr.2, që i bashkëlidhet vendimit nr.711, datë 27.12.2001 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, në kategorinë "I-b" shtohet emërtimi "Drejtor i Departamentit të Administratës Publike".

3. Lidhja nr.3 "Kategorizimi i pozicioneve të punës për funksionet e veçanta në Kryeministri dhe ministritë e linjës" zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

4. Numri i punonjësve të parashikuar për Departamentin e Administratës Publike dhe fondi i pagave, shpërblimeve dhe sigurimeve shoqërore, duke filluar nga data 1.12.2005, të kalojnë nga Kryeministria te Ministria e Brendshme.

5. Efektet financiare për Njësinë Antitrafik, për vitin 2005, të përballohen nga buxheti i vitit 2005 miratuar për Ministrinë e Brendshme.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 14.11.2005 për nëpunësit e Departamentit të Administratës Publike dhe të Njësisë Antitrafik, në Ministrinë e Brendshme, dhe nga data 30.11.2005 për nëpunësit e Kryeministrisë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.3

KATEGORIZIMI I POZICIONEVE TË PUNËS PËR FUNKSIONET
E VEÇANTA NË KRYEMINISTRI DHE MINISTRITË E LINJËS

INSTITUCIONI	POZICIONI	KATEGORIA E PAGËS
Kryeministria	Drejtor i Njësisë së Zbatimit të Projekteve të Bankës Botërore	II-a
	Jurist në Departamentin Juridik&të Koordinimit	II-b
	Inspektor në Departamentin e Kontrollit të Brendshëm Administrativ& të Antikorrupsionit	II-b
	Koordinator në Departamentin e Bashkërendimit të Strategjive&Koordinimit Strategjik me Donatorët	II-b
Ministria e Punës dhe Çeshtjeve Sociale	Drejtor i Inspektoratit Shtetëror të Punës	II-a
Ministria e Punëve të Jashtme	Përfaqësues ligjor i Zyrës së Përfaqësuesit Ligjor	II-b
	Përfaqësues i Zyrës së Minoriteteve	II-b
	Drejtor i Institutit të Diasporës	II-b
Ministria e Mjedisit	Kryeinspektor i Inspektoratit të Mjedisit	III-a
	Inspektor në Inspektoratin e Mjedisit	III-b
Ministria e Drejtësisë	Inspektor në Drejtorinë e Inspektimit Gjyqësor	III-a
Ministria e Brendshme	Drejtor i Njësisë Antitrafik	II-a
	Përgjegjës sektori në Departamentin e Administratës Publike	II-b
	Koordinator në Njësinë Antitrafik	III-a
Ministritë e linjës	Inspektor në Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm apo sektorët e auditimit të brendshëm	III-b